

Klauzola e pëlqimit paraprak

Unë, i nënshkruari, [_____emri / _____mbiemri i deklaruesit], deklaroj dhe garantoj me vullnetin tim të plotë dhe të lirë se informacioni i dhënë nga unë, është i vërtetë, i saktë dhe i plotë.

Duke kuptuar se, të dhënat e mia demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë, do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional, si dhe për faktin se LuteCredit Albania Sh.a. dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjithat masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mia:

I jap pëlqimin tim të plotë, të lirë LuteCredit Albania Sh.a. që, për qëllimet që përfshijnë:

1. Vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
2. Vlerësimin e rrezikut të kredisë përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time të kredisë me LuteCredit Albania Sh.a.;
3. Vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit;

të njihet me detyrimet e mia ndaj institucioneve financiare kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave të Regjistrin të Kredive, për të vlerësuar vlerën e ekspozimit kreditor në sistemin bankar e financiar, garancitë dhe besueshmërinë/aftësinë për të shlyer detyrimet financiare.

Gjithashtu, jap pëlqimin tim që LuteCredit Albania Sh.a. të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

Unë jam informuar siç duhet për të drejtën time për të kërkuar informacion mbi të dhënat e mia gjatë periudhës së mbajtjes së tyre nga LuteCredit Albania Sh.a. si dhe korrigjimin/rishikimin në raste kur ato janë të pasakta, të paplota. Për një qëllim të tillë, unë jam i vetëdijshëm që çdo kërkesë për sa më sipër mund t'ia drejtoj LuteCredit Albania Sh.a. si më poshtë:

• Në vëmendjen e Personi i kontaktit të institucionit financiar në të cilin mund të adresohen pretendimet mbi të dhënat e raportuara;

- Adresa: Rruga "Andon Zako Cajupi", Pallati Nr. 3, Hyrja Nr. 2, Kati 3, Tiranë, Shqipëri;
- E-mail: info@iute.al;
- Telefon: 044 50 5060;
- www.iute.al.

Unë kam lexuar dhe kuptuar me kujdes përmbajtjen e kësaj Klauzole të Pëlqimit Paraprak dhe njoh pasojat përkatëse ligjore në lidhje me përpunimin e të dhënave të mia personale, informacionit financiar dhe/ose çdo informacioni tjetër në lidhje me veten time në cilësinë e huamarrësit dhe, për këtë arsye unë e nënshkruaj këtë dokument me vullnetin tim të plotë dhe të lirë:

☐ Pranoj

☐ Nuk Pranoj

DEKLARUESI

[qytet]:-----

[datë (dd.mm.vvvv)]:-----

[emri] [mbiemri] : [nënshkrimi]